



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-018
Prishtinë, më 16 shkurt 2018, në orën 18:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 16 SHKURT 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Aida Dërguti, Kujtim Shala dhe Xhavit Haliti, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Albulena Haxhiu, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi dhe Avni Bytyqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i kërkesës së Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës për seancë të jashtëzakonshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, dhe të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme nga Kuvendi, më 18 shkurt 2018, me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar për seancë të jashtëzakonshme dhe përgatitjet për mbajtjen e kësaj seance diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Xhavit Haliti, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së, Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së, dhe Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në kohën e diskutimeve, nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti, e lëshoi mbledhjen e Kryesisë.

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me kërkesën e Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, dhe të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, për seancë të jashtëzakonshme, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 18 shkurt 2018, në orën 18:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 19:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri Veseli

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale